




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA	DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRATIVE
Dërguar më 10/01/2023		
Dërgatorg. Org. Ind.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-401604-0002787/23		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Plani i punës për vitin 2023

I. Hyrje

Në Komunën e Podujevës Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale punën e organizon në shërbimet primare shëndetësore- Sektori i Shëndetësisë, shërbimet sociale-sektori i Mirëqenies Sociale dhe Qendrën për Punë Sociale.

Objektivat kryesore të DSHMS për vitin 2023

1. Përparimi, parandalimi, mjekimi shërimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet,
2. Edukimi shëndetësor, imunizimi dhe vaksinimi,
3. Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor duke përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike.
4. Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesin themelor stomatologjik,
5. Rehabilitimin e bazuar në bashkësi,
6. Kujdesin shëndetësor riprodhues që përfshin kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisi, lindjes dhe lehonave si dhe metodat e planifikimit të familjes,
7. Zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitése,
8. Sigurimi i ujit dhe ushqimi cilësor,
9. Kryerja e shërbimeve specialistike dhe diagnostiko-analizave laboratorike e rëntgenologjike, ultrasonike ne kujdesin parësor shëndetësor,
10. Aftësimi mëtejmë permanent i punëtorëve shëndetësor për punë në rrethana të jashtëzakonshme-emergjente në bazë të Ligjit për kujdesin shëndetësor emergjent.
11. Furnizimi me barëra dhe material sanitari nga Lista esenciale e barërave dhe furnizimi me barna dhe reagensa për nevojat e QKMF kontrata me buxhet të DSHMS
12. *Servisimi i pajisjeve mjekësore, Furnizim me dokumentacion mjekësor, Furnizim me material higjenik, Furnizim me pelet, Furnizim me naftë për ngrohje, Furnizim me naftë për vutura (shërbimi shtëpiak shëndetësor), Furnizimi dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit, Furnizim me oksigen*
13. *Ndërtimi i QMF 3 – Bashkëfinancim me Qatar Charity – Komuna e Podujevës, Furnizim me pajisje mjekësore, Blerja e autoambulancave, Renovimi i objekteve shëndetësore, Investime kapitale – Administrata Shëndetësi – Ndërtimi i qendrës rezidenciale.*
14. *Përmirësim të kushteve të banimit përfshinë pranimin e kërkesave dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të banimit*

15. Identifikimi i familjeve në teren lidhur me nevojat sociale ekonomike dhe të banimit, identifikimin e personave të moshuar, vetmuar dhe hendikepuar.

16. Bashkëpunimi me MSH dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, në gjithë segmentet ku është e mundur dhe i nevojshëm ai.

- Bashkëpunimin me të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare përfshirë organizatat qeveritare, joqeveritare, donatorë të ndryshëm dhe njerëzit e vullnetit të mirë.
- Bashkëpunimi me MSH dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, në gjithë segmentet ku është e mundur dhe i nevojshëm ai.
- Identifikimi i familjeve në teren lidhur me nevojat sociale ekonomike dhe të banimit, identifikimin e personave të moshuar, vetmuar dhe hendikepuar.
- Puna e Qendrës për Punë Sociale mbështetët në idealet e humanitetit, barazisë, drejtësisë sociale si dhe përkushtimit ndaj qytetarëve, punëtorët janë të angazhuar që në mënyrë sa më profesionale të ofrojnë shërbime qytetarëve në nevojë të cilët në mënyra të ndryshme kanë kërkuar shërbime.

Sektori i Shëndetësisë- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)

I . Pjesa hyrëse

Planifikimi dhe programimi i punës për vitin 2023 është i bazuar në legjislacionin aktual për shëndetësi, mundësitë dhe nevojat e popullatës, resurseve humane dhe hapësira për zhvillimin e aktiviteteve mjekësore dhe jo mjekësore (trajnimet e ndryshe të stafit mjekësor).

Puna e QKMF Podujevë bazohet në Ligjin mbi shëndetësinë e Kosovës, Ligjin e punës, Statutin e QKMF dhe Aktet tjera nënligjore të Ministrisë së shëndetësisë.

Në vitin 2023 përkundër vështirësive që do të kemi në punë, Ne si menaxhment i QKMF-Podujevë presim rezultate të kënaqshme në pikëpamje të angazhimit të punëtorëve në procesin e

punës, përmirësimit të disiplinës në punë, organizimit me të mirë dhe efikas të punës, angazhimit maksimal të secilit punëtor, mjek, infermier dhe personel tjetër si në QKMF ashtu edhe në QMF dhe AMF në teren.

Kusht i qenësishëm për realizimin e suksesshëm të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara me këtë program pune, është jetësimi i plotë i detyrave që dalin nga Ligji për shëndetësi,

Ligji i punës, Statuti dhe aktet normative në drejtim të realizimit dhe krijimit të kushteve për punë qe kërkojnë: aktet

- **kualitet dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore**
- **kursim maksimal, racionalitet dhe modernizim të punës në bazë të arriturave më të reja shkencore,**
- **pajisja me mjete të nevojshme dhe aparaturë mjekësore.**
- **përcaktimi real i nevojave dhe mundësive materiale në shëndetësi**
- **krijimi i kushteve për perfeksionim profesional, specializime, trajnime sipas planeve të posaçme dhe strukturës ligjore.**

Me këtë program vjetor pune parashihen masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në QKMF, QMF dhe AMF, organizimi dhe udhëheqja, burimet njerëzore dhe plani finansiar për këtë vit.

Veprimtaria e QKMF, QMF dhe AMF është që të bëjë ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor popullatës së komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror nëpërmes të zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare.

Koncepti i Mjekësisë familjare konsiston që banorëve të komunës sonë t’iu ofroj kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës të bazuar në të dhëna shkencore dhe efikase përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë derë hyrëse për pacient në sistemin shëndetësor dhe njëheri pikë referuese për specialistet konsultativ në kujdesin parësor dhe në nivele tjera të kujdesit shëndetësor. Sipas strategjisë dhe standardeve të Mjekësisë familjare synohet që një mjek familjar së bashku me dy (2) infermieri do të ushtroj kujdes shëndetësor për 2000 banorë dhe 1. stomatolog dhe 2. teknik dental do të ushtrojnë kujdes oral stomatologjik për 6000 banorë, sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF.

Kujdesi parësor shëndetësor në QKMF zbatohet nga profesionistet shëndetësor:

1. Specialistet e mjekësisë familjare
2. Doktori i mjekësisë
3. Doktori i stomatologjisë
4. Infermieret familjare, dhe tekniket mjekësor

Kujdesi parësor shëndetësor përkrahet nga specialistet konsultat të QKM, si:

1. Specialisti i stomatologjisë.
2. Pediatri,

3. Gjinekologu-obstetër

4. Infermieret e mamitë.

5. Specialistet konsultat ekzistues, si: Specialisti i sëmundjeve të brendshme-, Specialisti i Mjekësisë së punës, Specialisti i sëmundjeve të mushkërive , Dermatovenerologjisë, Oftalmologjisë e specialist të tjera.

Në kuadër të mjekësisë familjare është edhe sistemi informativ shëndetësor, i cili grumbullon të dhënrat shëndetësore dhe ia dërgon ISHP në Prishtinë.

Hapësira, Objektet shëndetësore, Organizimi i punës, Udhëheqja dhe kuadrot në QKMF

a/Hapësira-

QKMF Podujevë, veprimtarinë e vetë do ta ushtroj në tri objekte shëndetësore në qendër dhe në 3 objekte të QMF dhe me 18 objekte të AMF të terrenit. Në qendër ka deri diku hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e veprimitarise ka më se 2000 m^2

E tërë hapësira për kryerjen e veprimitarise është gjithsejtë 3.640 m^2 . Këto objekte shëndetësore i plotësojnë kushtet higenik-teknike për ushtrim të veprimitarise shëndetësore.

b/Organizimi i punës, rrjeti i institacioneve shëndetësore, shërbimet dhe Udhëheqja

Institucioni shëndetësor QKMF në Podujevë i formuar në territorin e komunës është formë themelore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse shëndetësore në nivelin parësor.

Veprimtaria shëndetësore është organizuar me qëllim të sigurimit të kujdesit të përshtatshëm shëndetësor për qytetaret e komunës në kushte normale dhe në rrethana të jashtëzakonshme dhe në kushte emergjente. Duke siguruar kujdes shëndetësor për të gjithë dhe duke zbatuar masat dhe metoda bashkëkohore për veprimitari me interes të veçantë shoqëror.

Kujdesi parësor shëndetësor realizohet me tabelën e përcaktuar të çmimores të miratuar në MSH dhe e MF për nivelin primar në institucionin shëndetësor QKMF,QMF dhe AMF për grupe të popullatës: fëmijët deri 15vjeç, nxënësit e studentët, personat me të vjetër se 65 vjeç, anëtarët e ngushtë e familjeve të dëshmoreve, invalidët e luftës e të tjera, të varfërëtë me ndihma sociale dhe personat me aftësi të kufizuara që nuk janë të pakët, lironen nga pagesa.

Organizimi i punës bëhet në bazë të orarit mujor të punës për të gjitha njësitë organizative dhe shërbimet të cilat i përcakton drejtori i QKMF në fillim të çdo muaji. Orari i punës duhet të respektohet nga të gjithë punëtorët e institucionit neper shërbime. Në kuadër të QKMF janë të organizuara këto Departamente-Njësi ose Sektorë, si vijon:

A-Departamenti i Mjekësisë familjare, i përbërë:

1. Sektori i Mjekësisë familjare, (kujdestaria e natës, paliativi)
- Sektori i shëndetit publik.
- Njësia e SISH.
- Njësia e imunizimit dhe vaksinimit
- Sektori i shëndetit Oral.
- Emergjencia 24h.

2/Sektori konsultativ- Specialistika

- Pediatria
- Gjinekologja
- Pulmologja/DAT
- Dermatovenerologja.
- Oftalmologja.
- Njësia e Mjekësisë së punës

3.Sektori i diagnostikes

- Kabineti radiologjik - Laboratori.

B/Departamenti i administratës

- Njësia e personelit.
- Njësia juridike.
- Njësia për buxhet financa
- Njësia për shërbime teknike.

C/Materniteti 24h.Ordinanca gjinekologjike e Këshillimorja

C/Barnatorja Interne-Furnizimi me barëra nga lista esenciale.

❖ **Në kuadër të QKMF është i organizuar rrjeti i QMF dhe i AMF si vijon:**

1. **QKMF: Podujevë**
2. **QMF Kërpimeh, Lluzhan Orllan**

3. AMF: Llapashticë, Dumnicë, Gllamnik, Sfeçël, Shajkoc, Batllavë, Bradash, Majac, Bajqine, Pollate, Dobrtin, Herticë, Dyz, Lupç, Shtedim, Halabak Lagja e Kuvajtit-Ballofc, dhe Obrançë.

Kuadrot profesionalë

Realizimi i detyrave të parashtruara me këtë program pune për vitin 2023 në rend të parë varet nga numri i nevojshëm i kuadrore profesionale në shëndetësi si Mjek specialist të MF, Doktorë të mjekësisë, Doktorë të stomatologjisë dhe Infermiere etj.

QKMF ne Podujevë si institucion shëndetësor nuk ka kuadër të mjaftueshëm mjekësor për të kryer funksionin sipas Ligjit mbi shëndetësinë në Qendër dhe Teren. Pra, tereni nuk ka qenë dhe nuk është i mbuluar me kuadër shëndetësor si duhet, andaj për këtë arsy kemi nevojë për pranim edhe të një nunëri punëtorësh shëndetësor si vijon:

Nr.	Kuadri i nevojshëm	numeri
1.	Mjekë Familjar	5
2.	Stomatolog	2
3.	Teknik laborant	1
4.	Teknik Rentgeni	1
5.	Teknik Dental	3
6.	Infer.akusherike	2
7.	Infer.te përgjithshme	10
8.	Hixheniste	5
Gjithsej :		29

Shërbimet shëndetësore:

Gjatë vitit 2023 planifikohet që numri i shërbimeve shëndetësore të rritet si në Qendër, në QMF dhe AMF, duke pasur parasysh futjen në përdorim te aparaturave te reja dhe rritjen e numrit të shërbimeve sidomos në QMF-të. Pritet të ketë një rritje të shërbimeve shëndetësore krahasuar me vitin 2022 në këto shërbime:

- Emergencë-përdorimi i aparaturës së re mjekësore me të cilën disponohet, pritet të shënoj një rritje edhe më cilësore të shërbimeve shëndetësore.
- **Do të avancojmë, aparatura, pajisje në autoambulanca dhe zgjidhjen e statusit të vozitësve.**

- Laborator-puna me aparaturë të blerë dhe nga donacioni pritet të shënoj një rritje cilësore e të shërbimeve laboratorike si ne qendër njashtu edhe ne tre (3) QMF ne teren. Do të vazhdoj orari 07:00-23:00, do të kemi laboratorin biokimik në QMF –lluzhan çdo ditë pune dhe të shtunave , po ashtu edhe në QMF-Kërpmeħ çdo dite pune si dhe planifikojmë te startojmë me kryerjen e troponinës në qendër
- Këshillimorja për Diabet dhe Hipertension e cila vitin e kaluar ka ofruar **15.842.00** vizita + shërbime e cila ka ndihmuar shumë sidomos të sëmurë me Diabet dhe Hipertension. Sponzorizimi i këtij projekti do të jetë edhe më i suksesshëm nëse kemi sponzorizues që

ofrojnë donacion për një funksionalizim më të mirëfilltë dhe më funksional, i cili është shumë domethënës për kategoritë e lartpërmendura. Në kuadër të këtij shërbimi janë të

angazhuara dy (2) Infermiere të diplomuara të cilat me performancë e tyre kanë ndihmuar shumë këto kategori.

Planifikojmë që ky shërbim do te zgjerohet në shtrirjen e shërbimeve në kuadër të dhënes së këshillave për menaxhimin e Hipertensionit të Diabetit dhe të përpunimit të plagëve diabetike si dhe menaxhimit standard të terapisë si dhe dhënes së këshillave për ushqyeshmëri.

- **Planifikojmë trajnim të stafit superior dhe të mesëm për trajtim të shputës diabetike**
 - Imunizimit t'i kushtohet rëndësi e veçantë, kërkojmë që kjo të jetë vazhdimesi e përhershme në realizimin e suksesshëm të vaksinimit.
 - Shërbimi stomatologjik oral-Planifikohet vazhdimi me punë e shërbimeve stomatologjike në QMF: Orllan, Kërpimeħ, Lluzhan. Kjo bëhet me qëllim që QMF-të të gëzojnë statusin e plotë, pasi që ndodhen në afersi të shkollave dhe nxënësit të kenë qasje të lehtë në këto shërbime, ku kjo paraqet një parametër të rëndësishëm në implementimin e Mjekësisë familjare. Kësaj do t'i ndihmoj dukshëm rajonizimi të
 - qytetit të Podujevës në mënyrë që qytetarët të drejtohen për ndihmën mjekësore aty ku e kanë me afér.

- **Planifikohet zgjerimi i shërbimeve stomatologjike -qendër-zgjerim me orar prej 07:00-23:00, çdo ditë pune plus vikendeve dhe Lluzhan edhe të shtunave ku synimet tona janë që edhe AMF-të duhet të ketë stomatolog.**
- QKMF,QMF dhe AMF në teren veprimtarin e tyre themelore e ushtrojnë duke ofruar shërbime shëndetësore, qytetareve të komunës që kërkojnë ndihmën mjekësore. Planifikimi i shërbimeve shëndetësore në vitin 2023, bazohet në numrin e përgjithshëm të banorëve të komunës, mundësive hapësinore të objekteve, potencialit kadrovik, patologjisë të sëmundjeve të popullsisë, epidemitë e ndryshme, gjendjet e jashtëzakonshme dhe emergjente nga fatkeqësitet elementare, epidemitë e ndryshme, lëndime dhe helmime masovike, tërmetet, zjarret, vërshimet, raste të bioterorizmit të cilat kanë ndikim në shtimin e numrit të shërbimeve shëndetësore. Numri i shërbimeve do të rritet për afro 5-10% duke pasur për bazë edhe shtimin e shërbimeve shëndetësore të cilat deri më sot nuk i kane marre qytetarët.

Këtë vit duhet kushtuar kujdes të veçantë realizimit të planit vjetor të imunizimit dhe të vaksinimit, që gjithsesi suksesi të jetë mbi 96%. Duhet vazhduar me vaksinimin kundër COVID-19, si dhe gripit të rëndomtë.

- **Planifikohet të vazhdojmë punën me dy ndërrime në QMF-Orllan, ndërsa QMF Lluzhan dhe QMF-Kërpimeh do të zgjatet orari nga 0ra 07:00-23:, do të funksionalizojmë shërbimin në AMF-Gllamnik çdo ditë pune dhe do të vazhdoj orari i rregullt në teren.**
- **Do të vazhdojë puna në shërbimin e Paliativit prej orës 08:00- 19:00.**
- **Do të vazhdojë puna e vizitave shtëpiake për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0-3 vjeç.**
- **Do të formohet ekipa geriatrike , do të bëhen vizitat sistematike të nxënësve.**

Shërbimet jo shëndetësore

Në Departamentin e Administratës të kryhen të gjitha punët administrative-juridike dhe të kontabilitetit të QKMF nëpërmes zyrave te cilat janë njësi të saj. Do te kushtohet rëndësi e veçante afarizmit materialo-financiar, pagesave, bashkë pagesave dhe të mbahen pasqyrat financiare sipas udhëzimeve dhe ligjit.

- **SISH Sistemi informativ shëndetësor i QKMF në Podujevë (SISH-i) gjatë vitit 2023**

Planifikojmë që në bazë të aplikimit të sistemit të ri të futjes së të dhënave në kompjuter edhe ky shërbim ta zgjeroj rrjetin e vetë dhe të lidhet në të njëjtën kohë edhe me shërbimet gjegjëse mjekësore në teren , në mënyre që në çdo kohë të kemi qasje në përmbledhjen e të dhënave për shërbimet e kryera dhe njëkohësisht këto të dhëna t'i transferojmë në nivelet tjera shëndetësore të sistemit që ky shërbim të shpërndahet në minimum 4 pika në teren kryesisht në QMF, ku volumi i punës është më i madh.

- **Presim funksionalizimin të plotë të SISH-t në çdo njësi/sektor.**

Investimet tjera

Për vitin 2023 planifikojmë si vijon:

Finalizimi i projekteve të parapara për vitin 2023

- menaxhimi i radhës për pacient
- Sigurimi i tabelave orjentuese në oborrin e QKMF-së (city light) me ndriçim
- Planifikimi aty për aty i ndonjë projekti varësisht nga mundësitat financiare
- Vazhdimi i programit për trajnim të stafit të mesëm mjekësor
- Ndërtimi i Urgjencës me bashkëfinancim
- Inventar për nevoja të shërbimeve

✓ Blerja e pajisjeve mjekësore :

- Rëntgen digital
- Rëntgen mobil për emergjencë
- X-ray dental për shërbimin e stomatologjisë
- Aparate e mjete pune për shërbime të QKMF dhe teren

✓

Blerja e automjeteve

- Autoambulancë për Emergjnencë
- Mini-autoambulancë për kujdes paliativ
- Automjet për nevoja të pacientëve me hemodializë
- Automjet për nevoja të vaksinimit

- ✓ **Në kuadër të renovimeve**
 - Pjesërisht nyjat sanitare dhe banjat në qendër dhe teren
 - Rregullimi i disa oborreve të AMF-ve
 - Rrethimi i oborrit QMF-Lluzhan dhe AMF-Dobratin
 - Rregullimi i sporteve në : QMF-të : Lluzhan, Orllan , Kërpimeh
- ✓ **Vazhdojnë kontratat e furnizimit me barëra, reagensa dhe filam RO.**
- ✓ **Servisimi i aparaturave për shërbimet e :**
 - Stomatologjisë
 - Rëntgenit
 - Ultrazërit
 - Mamografisë
 - Laboratorit
- ✓ Kamerat dhe sistemi i regjistrimit Hyrje –Dalje të personelit në :
 - QMF-të : Lluzhan , Orllan , Kërpimeh
 - Mirëmbajtja e lifteve
 - Kartat ID për personel
 - Tiketat hyrëse për pagesë të Laurës së QKMF-së
 - Uniformat, qarqafët
 - DDD

UDHËHEQJA E QKMF

QKMF-në në Podujevë e udhëheq Drejtori i cili është menaxhues-udhëheqës. Drejtori i ka të gjitha autorizimet për përfaqësim juridik brenda veprimtarisë së QKMF-së. Është përgjegjës për afarizëm, e prezanton dhe e përfaqëson QKMF-në dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punë. Drejtori e udhëheq punën profesionale të QKMF në bashkëpunim me Këshillin drejtues, Këshillin profesional dhe Kolegjumet profesionale të njësive organizative të QKMF.

Drejtori e zgjedh Këshillin Drejtues, si trup të QKMF. Drejtori e udhëheq Këshillin Drejtues. Drejtori zbaton Ligjin mbi shëndetësinë, Ligjin e punës, Statutin dhe aktet tjera normative te QKMF-së në Podujevë.

Këshilli Drejtues në propozim të Drejtorit, formon trupa profesionale, si:

- Këshillin profesional

- Kolegjin profesional,
- Komisionin disiplinor,
- Komisionin për ankesa të QKMF,
- Komitetin për cilësi të shërbimeve-Koordinatorin ,
- Komitetin për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe Komisionin etik-profesional.

Mbikëqyrjen e brendshme profesionale, përveç Drejtorit e bënë edhe Krye-shefi i departamentit të mjekësisë familjare, Koordinatori për sigurimin e cilësisë dhe Kryetekniku .

Pjesa material-financiare-Plani finanziar

QKMF në Podujevë gjatë vitit të kaluar nuk ka pasur ndonjë problem të natyrës materialo-financiare. Ky institucion shëndetësor që ushtron veprimitari shëndetësore i siguron mjetet për punë duke zbatuar programin e kujdesit shëndetësor në bazë të:

A/Llojeve, vëllimit dhe cilësisë së shërbimeve sipas çmimeve të shërbimeve.

B/Numrit të banorëve të komunës që mbulohet me shërbimet e kujdesit shëndetësor.

Sigurimi i mjeteve financiare për QKMF bëhet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe planit finansiar për këtë vit i cili do t'i dërgohet Drejtorisë për shëndetësisë dhe mirëqenës sociale.

Ministrisë për ekonomi dhe financa. Sigurimi i mjeteve mund të bëhet edhe nga Fondi i sigurimeve shëndetësore dhe nga të hyrat vetanake: Garanti i administratës komunale, Granati i shëndetësisë komunale dhe eventualisht nga ndonjë donacion. Plani i të hyrave për këtë vit. (Shih. Planin finansiar) nga i cili parashihen: Pagat e punëtorëve Mallra e shërbime, Blerja, lëndë djegëse, mirëmbajtja e objekteve, reprezentacioni, Shërbime komunale, subvencione dhe kapitale.

Po theksojmë se me një organizim me të mire të punës dhe në saje të angazhimit dhe përpjekjeve maksimale të të gjithë punëtorëve në realizimin e detyrate dhe punëve të planifikuara për këtë vit, realisht pritet shtimi i vëllimit të shërbimeve shëndetësore së paku për 10% në raport me vitin 2022, ku edhe përkundër si pasojë situatës pandemike COVID-19 shërbimet janë kryer me sukses.

Ky program pune edhe pse është i bazuar në tregues real, nuk mund të jetë real, sepse në këtë vit shtrohen edhe detyra pune që nuk i kemi planifikuar ose paraparë si në ofrimin e

shërbimeve shëndetësore, vaksinimin e fëmijëve, rivaksinim, vizitat të ndryshme sistematike, epidemitë të

ndryshme, situata emergjente dhe të jashtëzakonshme, nga kjo del se koha mund të imponoj shumë punë dhe detyra për ta mbaruar me sukses këtë vit afarist.

Detyrë parësore e secilit punëtor shëndetësor dhe punëtorëve tjera dhe i shërbimeve do të jetë angazhimi maksimal për sendërtimin e plotë të këtij programit të punës.

Një numër i madh detyrash që nuk janë paraparë me këtë program pune, të cilat do t'i imponoj koha dhe momenti, QKMF do t'i kryen me mjaft sukses.

QKMF në Podujevë në përbërje të vet ka :

- **QMF**.....3
- **1.QMF- Lluzhan ,2. QMF-Kërpimeh ,3. QMF- Orllan,**
- **AMF**.....18

1.AMF Pollatë, 2.AMF- Bajqine, 3.AMF- Dobratin, 4. AMF - Bradash, 5.AMF- Llapashticë, 6.AMF - Gllamnik, 7.AMF - Dumnicë, 8.AMF- Shtedim, 9.AMF - Herticë, 10.AMF- Shajkoc, 11.AMF - Sfeqel, 12.AMF- Batllavë, 13.AMF - Dyz, 14.AMF- Majac, 15.AMF- Lupq, 16. AMF Lagja e Kuvajtit, 17.AMF -Obranqë,AMF-Halabak.

QKMF- Podujevë kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:

- 1. Përparimi, parandalimi, mjekimi, shërimi dhe rehabilitimi që ka të bëj me sëmundjet, çrrëgullimet dhe lëndimet,**
- 2. Edukimi i vazhdueshëm profesional,**
- 3. Imunizimi dhe vaksinimi**
- 4. Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesi parësor shëndetësor përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike,**
- 5. Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesi themelor stomatologjik,**
- 6. Kujdesi për shëndetin mendor bazuar në bashkësi**
- 7. Kujdesi shëndetësor riprodhues që përfshinë kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisi, lindjes, dhe lehonave ,si dhe metodat e planifikimit te familjes**
- 8. Zbulimi i hershem i sëmundjeve ngjitime,**
- 9. Kryerja e shërbimeve specialistike dhe diagnostike, analizave laboratorike dhe rëntgenologjike në kujdesin parësor shëndetësor**

- 10. Diagnostifikimi i hershëm dhe trajtimi i tuberkulozit**
- 11. Organizimi i shërbimeve Urgjente dhe Emergjente si pjesë e sistemit unik,**
- 12. Shërbimi i kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë, 13. Mbrojtja e parashkolloreve nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve, dhe të rinjve në shkollat fillore dhe të mesme . 14. Shërbimi Paliativ.**

Shërbimet që ofrohen nëpër QMF-të dhe AMF-të në kuadër të QKMF-Podujevë
Shërbimet që ofrohen QMF – Lluzhan , Kërpimeh, Lluzhan:

Nr.	Shërbimet
1.	Shërbimet e mjekësisë familjare
2.	Shërbimi i sëmundjeve të dhëmbëve
3.	Laboratori
4.	Shërbimi i vaksinimit

- *Ambulantat e Mjekësisë Familjare (AMF- të) janë të pavarura nga Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF- të)*

Shërbimet që ofrohen në 18 AMF -të:

Nr.	Shërbimet
1.	Shërbimi i mjekësisë familjare
2.	Shërbimi i vaksinimit

Projektet e planifikuara për vitin 2023

Aktiviteti	Afati Kohor	Kosto financiare
<i>Furnizime me barna dhe reagensa</i>	<i>Shkurt – Dhjetor 2023</i>	<i>413,706.00</i>
<i>Servisimi i pajisjeve mjekësore</i>	<i>Mars – Dhjetor 2023</i>	<i>35,000.00</i>
<i>Furnizimi me pajisje</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>10,000.00</i>
<i>Furnizim me dokumentacion mjekësor</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>55,000.00</i>
<i>Furnizim me material higjenik</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>30,000.00</i>
<i>Furnizim me pelet</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>65,000.00</i>
<i>Furnizim me naftë për ngrohje</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>25,000.00</i>
<i>Furnizim me naftë për vetura (shërbimi shtëpiak shëndetësor)</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>150,000.00</i>
<i>Furnizimi dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>5,000.00</i>
<i>Furnizim me oksigjen</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>7,000.00</i>
<i>Shërbime kontraktuese</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>50,000.00</i>
INVESTIMET KAPITALE		
<i>Ndërtimi i QMF 3 – Bashkëfinancim me Qatar Charity – Komuna e Podujevës</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>200,000.00</i>
<i>Furnizim me pajisje mjekësore</i>	<i>Janar – Dhjetor 2023</i>	<i>189,981.00</i>
<i>Blerja e autoambulancave</i>	<i>Shkurt – Qershori 2023</i>	<i>150,000.00</i>
<i>Renovimi i objekteve shëndetësore</i>	<i>Mars – Dhjetor 2023</i>	<i>50,000.00</i>
<i>Investime kapitale – Administrata Shëndetësi – Ndërtimi i qendrës residenciale</i>	<i>Mars – Dhjetor 2023</i>	<i>160,000.00</i>

Sektori për Mirëgenie Sociale

- Konsulta të vazhdueshme me palë për kërkesa të ndryshme, të cilat i evidentojmë si raste me prioritet për shqyrtim.
- Vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve të familjeve aplikuese për subvencione shëndetësore dhe marrja e vendimit për t'iu ofruar ndihmë financiare momentale.
- Përkrahjen e OJQ-ve të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Podujevës, të cilat aktivitet kryesor kanë ofrimin e shërbimeve socio-ekonomike, të cilat për përfitimin e subvencioneve i nënshtrohen parimeve dhe dispozitave të përgjithshme dhe të veçanta të Rregullores së Ministrisë së Financave për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, që është në fuqi .
- Pranimin dhe regjistrimin e të gjitha kërkesave në bazën e të dhënave të familjeve me nevojë dhe me gjendje jo të mirë socio-ekonomike si dhe regjistrimin e përfituesëve në bazën e të dhënave.
- Bashkëpunimin me donator të ndryshëm, njerëz afarist dhe solidar, shoqata dhe organizata humanitare, për t'i përkrahur familjet me nevojë dhe me gjendje jo të mirë socio-ekonomike në Komunën e Podujevës me pako ushqimore dhe higjenike, mish, lavatriçe, shporetë për ngrohje me dru, furnizim me lëndë djegëse (dru për ngrohje), veshmbathje, hapjen e puseve me ujë të pijshëm etj.
- Vizitat në teren familjeve me nevojë dhe me gjendje jo të mire socio-ekonomike sipas kërkesave të parashtruara.
- Shqyrtimin dhe përpilimin e listave prioritare për ndihmë familjeve me nevojë dhe me gjendje jo të mirë socio-ekonomike.
- Evidencimin dhe verifikimin sipas kërkesave të parashtruara nga familjet me të moshuar/a, vettmar/a dhe hendikepuar/a duke i'u ofruar ndihmë në kuadër të mundësive të DSHMS-së.
- Do të vazhdohet procesi i hapjes së puseve me ujë të pijshëm sipas kërkesave të parashtruara pranë DSHMS-së për familjet e përzgjedhura në bashkëpunim me Organizatën “Qatar Charity”.
- Vizitat ad-hoc të cilat bëhen mbi bazën e një kërkese të caktuar.

Strehimi

Plani i punës për banim dhe përmirësim të kushteve të banimit përfshinë pranimin e kërkesave dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të banimit si dhe propozimet konkrete për përparësinë e këtyre familjeve për të ndihmuar qytetarët e Komunës së Podujevës që nuk kanë mundësi të sigurojnë banim.

Plani i punës për banim për vitin 2023 ka këto objektiva:

- Përzgjedhjen dhe vendosjen e 22 familjeve në Lagjen e ndërtuar në bashkëpunim me Fondacionin Firdeus dhe Shqiptarët për Shqiptarët,
- Vlerësimin e gjendjes së banimit të familjeve në Lagjen e Dëshmorëve,
- Vizitat dhe vlerësimin e gjendjes tek të gjitha familjet të cilat kërkojnë strehim, ndërtim të shtëpive, riparim apo pagesa për qera,
- Bashkëpunimin me donatorë për të bashkë financuar projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për qytetare,
- Bashkëpunimin me biznese për partneritet publiko privat
- Bashkëpunimi me Ministri për ndërtim dhe renovim të shtëpive për rastet sociale dhe familjet nga komunitetet.

Prioritet kryesor i këtij plani është që gjatë kësaj periudhe Komuna e Podujevës të jetë në gjendje të ndihmojë familje duke ju siguruar strehim, ndërtim apo riparim të shtëpive në bashkëfinancim me donatorë apo duke paguar një pjesë të qerasë për rastet janë në kushte të rendë socio ekonomike.

Në bazë të këtij plani do të bëhet regjistrimi dhe shqyrtimi i kërkesave të familjeve të cilët aplikojnë për banim apo përmirësim të kushteve të banimit në bazën e të dhënave, nga ku do të jetë më e lehtë qasja në kërkesat e tyre. Vizitat në shtëpi do të bëhen në mënyrë që të bëhet verifikimi i gjendjes së banimit dhe socio ekonomike.

MISIONI I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

QPS si mision ka angazhimet në zhvillimin e Legjislacionit te ri, vendosjen e standardeve të duhura për shërbimet dhe mbrojtën sociale ,mbështetjen e fort dhe të qëndrueshme financiare, duke përfshirë kriteret legitime dhe transparente.

QPS edhe në të ardhmen vazhdon të mbetet në realizimin dhe zhvillimin e politikave sociale si dhe mbrojtën e kategorive të ndryshme të qytetarëve që kanë nevojë.

- Zhvillimi i shërbimeve sociale në harmoni me kërkesat e grupeve të ndryshme
 - Fëmijët e braktisur
 - Viktimat e trafikimit
 - Viktimat e dhunës në familje
 - viktimat e abuzimit të fëmijëve,
 - Rastet e të sëmurëve
 - Te moshuarit
 - Personat me aftësi të kufizuara
 - Të kthyerit etj.
-
- Zbatimi i Ligjit të asistencë sociale dhe i kritereve për përfituesit e asistencës sociale më qëllim që ndihma sociale të arrijë tek të varfëritë.
 - Zhvillimi i infrastrukturës sociale dhe strehimi i përkohshëm për grupe të ndryshme të dëmtuara ne situata emergjente dhe rritjen e shtëpive me bazë në komunitet për mbrojtën e fëmijëve, personave të moshuar dhe me aftësi të kufizuara.
 - Ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë banorët e komunës; Nga këto 3 shërbime
 - Shërbime sociale
 - Shërbimet me asistencë sociale
 - shërbime administrative-financiare

QËLLIMI I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

Qëllimi i QPS-së është zbutja e varfërisë, dhënja e shërbimeve sociale dhe përkujdesja institucionale për persona me aftësi të kufizuara dhe të moshuar për të gjithë banorët e Komunës së Podujevës pa dallim etniteti dhe besimi.

Qëllimi kryesor i QPS-së është që ti bëjë renditjen e prioriteteve;

- 1.Zbutja e varfërisë.
- 2.Ofrimi i shërbimeve sociale për të gjithë banorët e komunës pa dallim gjinie moshe, etnije dhe religjioni.
- 3.Dhënja e ndihmës familjeve në gjendje të vështire materiale dhe shëndetësore.
- 4.Hartimi i politikave sociale në bazë të standardeve ndërkombëtare të mbrojtës sociale.
- 5.Ngritja e cilësisë së shërbimeve sociale dhe hartimi i Strategjisë dhe politikave sociale në nivel, komunal.

6.Rritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve profesionale, OJQ-ve dhe zyrave të ndryshme për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

7.Avancimi i shërbimeve dhe përkujdesja për personat e moshuar, fëmijët dhe personat me të meta mendore duke u ofruar strehim dhe kushte te mira;

- Graçanicë
- Shtime
- Ferizaj dhe
- Vushtrri.

8.Avancimi i sistemit të teknologjisë informative

9.Trajnimi i stafit më qëllim ngritjes profesionale dhe aftësimi për një shërbim me cilësor.

10.Krijimi i një administrate profesionale dhe efikase.

11.Bashkepunimi me organet komunale ,DMS Policin ,Shkollën, Shëndetësinë, Gjykatat, Prokurorin, Strehimoret, dhe me të gjitha agjencionet qeveritare dhe jo qeveritare qe merren me trajtimin e njerëzve në nevojë.

12.Realizimi me kohe të shërbimeve sociale.

AKTIVITETET E ZHVILLUARA

QPS gjatë vitit 2022 ka ofruar shërbime sociale ,shërbime të ndihmave sociale dhe shërbime administrative në harmoni me ligje, UA për të gjithë qytetarët pa dallim etnie, gjinie, feje etj.

QPS është orientuar në plotësimin e vendeve të lira të punës.

QPS ka nevojë edhe për një numër më të madh të punëtorëve duke krahasuar me numrin e popullsisë i cili është mbi 80.000 banor me sipërfaqe 663 km² dhe me 78 fshatra. QPS përkatesisht punëtoret e shërbimit social, shërbimit të asistencës sociale përveç detyrave të punës së përditishme, me vete iniciativë gjatë verifikimit të rasteve sociale në terren kanë zbuluar shumë raste të reja për të cilat asistenca sociale ishte shumë e nevojshme, prandaj atyre familjeve ju kemi ofruar shërbime duke i udhëzuar për kompletimin e dokumentacionit dhe ka pasur raste ku vetë punëtori e ka ndihmuar palën me i rregulluar dokumentacionin.

QPS asnjëherë nuk ka neglizhuar në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës të cilat kane qenë në kompetencë të saj, verifikimin e rasteve të reja e as në riverifikim dhe rivlerësim. Në baze të punës se mirë kemi riaktivizuar familje që me parë kanë qenë në asistencë sociale për shkak të keqësimit të gjendjes së rendë ekonomike.

Gjatë këtij viti është trajnuar stafi i asistencës sociale si dhe ai i shërbimit social. Janë bërë Trajnimi: vetëdijesimi i femrës për raportimin e dhunës në familje, Trajnim online për parandalimin dhe trajimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore, HANDIKOSI Trajnim: Avancimi I kapaciteteve për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Trajnim online për të drejtat e njeriut dhe shërbimet sociale dhe familjare, Trajnim bashkëpunimi ndër sektorial dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin nën moshën e përgjegjësisë penale, si dhe mënyra e zbatimit të ligjeve dhe udhëzimeve administrative.

REALIZIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA

Për realizimin e të drejtave të qytetarëve DKSHMS DHE QPS-ja në Podujevë do të bazohet në infrastrukturën ligjore e cila është duke u implementuar, statutin e Qendrës dhe rregulloreve të aprovuara nga organet komunale në fushën e mbrojtjes sociale:

- Ligji mbi familjet dhe marrëdhëniet familjare 10/84
- Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare 02/L-17, duke u bazuar në rregulloren 2001/2
 - i dt. 15 maj 2001.
- Ligji mbi familjen 2004/32
- Kodi penal i Kosovës
- Ligji i Procedurës jashtë kontestimore
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi te drejtat e Fëmijëve 20 nëntor 1989
- Konventa mbi mbrojtën e Fëmijëve në fushën e adaptimit 1993.
- Kodi i procedurës penale
- Ligji mbi arsimin paraunverzitar të vitit 2011
- Konventa mbi ndalesën e punëve të renda të fëmijëve
- Konventa mbi minimumin e moshës në punët e rënda
- Konventa mbi moshën minimale për themelin e marrëdhënieς së punës 1973
- Ligji mbi asistencën sociale 15/2005
- **U d h ë z i m e t A d m i n i s t r a t i v e**

10	Dhuna në familje	Sthimi i viktme	2023	MPMS	QPS,DMS dhe MPMS	PO	
11	Trafikimi	Bashkepunim i me partnered partneret	2023	Përkohshëm	QPS	PO	
12	Trainimet	PO	2023	Përhershëm	MPMS	PO	
13	Informimi	Këshillimi i familjëve	2023	Përhershëm	QPS	PO	
14	Verifikimi i rasteve	Për të gjithë aplikuesit	2023	Përhershëm	QPS	PO	
15	Menaxhimi i rasteve	Në bazë të udhëzimeve	2023	Përhershëm	QPS	PO	
16	Respektimi i afateve	Në bazë të afatve të parapara me ligj	2023	Përhershëm			
17	Riverifikimi i rasteve	Në bazë të kërkesave të dalëve	2023	Përkohshëm	QPS	PO	
18	Udhëzimi i familjeve me nevojë për	Për të drejtat që ju takoinë në bazë të	2023	Përhershëm	QPS	PO	
19	Identifikimi i nevojave reale për numrin e të punëve në QPS	Në bazë të vëllimit të Të hyrat dhe shpenzimet	2023	Përhershëm	Komuna	PO	
20	Planifikimi i buxhetit	Të hyrat dhe shpenzimet	2023	Përhershëm	Komuna	PO	

OBJEKTIVAT E QPS PËR 2023

Nr	Objektivat	Aktivitet	Afati	Kostoja	Përgjegjesitë	Rezultatet	Vështresit
1	Aplikimi i Ligjeve	I obligueshem	Përhereshem	MPMS	punetoret	po	jo
2	Mbrotja e fëmijëve pa perkujdesje prindëore	Perkohshem	Perkohshem	po	QPS,DM S dhe MPMS	PO	Ka sfida
3	Fëmijet e braktisur	Caktimi i kujdestarit.	Përkohshëm	po		po	
4	Fëmijët e rrezikuar	Mbrotja,identifikimi dhe strehimi.	2023	MPMS	MPMS	PO	
5	Femijët me sjellje associale	Bashkpunimi me prindër shkolla ,psikolog dhe risocializimi.	2023	MPMS	QPS	PO	
6	Strehimi familjar	Sensibilizimi i opinionit	2023	MPMS	QPS	PO	
7	Birësimi- adoptimi	Hulumtimi i Familijeve adoptuese	2023	MPMS	QPS	PO	
8	Besimi i fëmijve	Besushmeria e fëmijeve në bashkësi familjare me rastin e ndarjes se prindërve	2023	MPMS	QPS	PO	
9	Mbrotja e personave të moshuar	Strehimi dhe vizita	2023	MPMS	QPS,DMS dhe MPMS	PO	

AKTIVITETET TJERA SHTESË PËR VITIN 2023

Zyrtarët e shërbimit social përveç obligimeve të rregullta do të punojnë edhe në projektin e fëmijëve në punë sepse kjo kategori është mjaftë shqetësuese, kur dihet se numri i madh i të pa punëve, duhet të bashkëpunojmë me OJQ-në si dhe të punojmë me fëmijët lypstarë etj.

Në kuadër të aktivitetave shtesë planifikojmë që për vitin 2023 të organizohen trajnime në këto fusha;

- Trajnimi psiko-social për të riatdhesuarit dhe profilizimi ekonomik i personave të riatdhesuar
 - Trajnime lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore
 - Trajnim për drogat dhe narkomanin
 - Trajnim lidhur me dhunën në familje
 - Trajnimi për implementimin e ligjit për të mitur
 - Trajnimi lidhur me implementimin e ligjit për shërbime sociale dhe familjare
 - Trajnim Menagjimi i rasteve dhe puna ndër sektoriale për mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin që janë nen moshën e përgjegjësisë penale
 - Trajnim për vizitat në shtëpi për shëndetin e nënave dhe fëmijëve dhe rëndësia e këshillimit psiko-social
 - Trajnim Menagjimi i rasteve të fëmijëve viktima të abuzimit seksual
 - Sipas mundësive QPS të pajiset me literature psiko- sociale
 - Funkksionalizimi i TMR
 - Trajnimi i stafit lidhur me menaxhimin e rasteve
 - Pajisja e QPS me kompjuterë, aparaturë teknike sipas nevojave që kërkojnë QPS

Podujevë, 2023



Aprovuar nga:

Drejtoresh e DSHMS

Adelina Stublla

**Formulari per kerkese apo ankesë**

Drejtoriati/Njesia
Zyra e Kryetarit

Data 10/01/2023

Mos shkruani në këtë pjesë

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**Emri dhe mbiemri**Drejtoria e Shendetësisë dhe Mirëqenjës
sociale**Adresa e vendbanimit**

Zahir Pajaziti/

Numri i tel. fiks**Numri i tel. mobil**

00000000

Numri personal

06

E-mail Adresa**Numri i protokolit****02-401/04-0002787/23****Afat i zgjedhjes**

09/02/2023

Vendimi**2. Mënyra e pranimit**

Raport

Statusi i lëndës

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Plani i punes per vitin 2023.

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësiUnë Drejtoria e Shendetësisë dhe vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.
Mirëqenje sociale

(Nënshtrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: Rafet Hasani